



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Nr. 3150/9 Prot.

Pogradec, më 28.03. 2025

VENDIM

NR. 75, DATË 28.08.2025

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 28.07.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli i Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 28.07.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 28.07.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV/ KRYETARE E KËSHILLIT

Miranda OLLDASHI

1.Miratuar me 20 vota

2.Vota Pro 20

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 28.08.2025



ORA : 12:_00

JANË PREZENT 19 KËSHILLTARËPROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK POGRADEC DATE _28_. _07_. _2025_, ME KËTË REND DITE.

Ju njoftojmë se ditën e Hene, më datë 28.07.2025, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Projekt – Vendim : Miratimi i Procesverbalit të datës 25.06.2025.
4. Leximi i vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 25.06.2025.
5. Projekt – Vendim : Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2025.
6. Projekt – Vendim: Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec (faza1)
7. Projekt – Vendim:Miratimin e planit të masave për të dalë nga gjendja me problem financiare.
8. Projekt – Vendim: Për miratimin e bonusit të qerasë për znj.Mirela Basholli në Bashkinë Pogradec.
9. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare për znj. Dhurata Balliu, familje që ka pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/ paisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve.
10. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare z.Agron Qose, Trebinjë, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.
11. Projekt – Vendim: Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35,5200 ha, të ndodhura në njësinë administrative Cërravë që mund të jepen me qira.
12. Projekt – Vendim: Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotovoltaikë(stacionet, bazamentet dhe objektet

përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m² (treqind e trmijë e dyqind e pesëdhjete e nentëmijë) m².

13. Projekt – Vendim: Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-2030 të Bashkisë Pogradec.

14. Projekt – Vendim: Disa shtesa në vendimin e Këshillit Bashkiak nr 124, datë 27.11.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë”

15. Projekt – Vendim: Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.105, datë 02.12.2021 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “Harta që përcakton rrugët e qytetit , të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”, I ndryshuar.

16. Informacion për “Barometri I barazisë gjinore, Bashkia Pogradec, 2024 ”

17. Të tjera.

1.Projekt – vendim :”Miratimi I Rendit të ditës”.

Diskutime

M.Kamolli:Ju pershendes dhe falenderoj qe jeni prezent ne mbledhjen e radhes te thirrur ne baze e ligjit 139.Jane present 19 keshilltare. Mbledhjen e deklaroj te hapur.

Kemi 4 projekt-vendime shtese:

1: Per dhenien e ndihmes financiare per z.Edmond Piperi.

2:Per miratimin e planit te arsimit parauniversitar ne Bashkine Pogradec.

3: Per miratimin ne parim te dhenies me qira ne favor te individve kerkues per kryerjen e operacioneve kerkues per kryerjen e operacioneve te kerkim-zbulimit hidrokarbure,gjeologjike e minerare,uji,vendosje objektesh te ndryshme ndihmse ne siperfaqe te pasurise me siperfaqe totale 40000 m2(dyzet mije)m2.

4.Per miratimin e planit te integritimit per Bashkine Pogradec 2025-2028.

Gjate mbledhjes se komisioneve pame te arsyeshme qe pika nr.11. nr.12. nr.13. dhe pika nr.20 e rendit te dites te kaloje per konsultim public.

Ateher ju ftoj ta hedhim ne votim rendin e dites me te gjitha ndryshimet qe u thane.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.07. 2025

2. Pika nr ____ : 2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.

Diskutime

M.Kamolli :Nwse dikush nga kwshilltaret ka konflikt interesi me ndonje nga pikat e rendit te dites ju lutem te deklarohet.

Mbledhje e KëshilBashkiak

Pogradec më 28.07. 2025.

3.Pika nr : “Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 25.06.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec” .

M.Kamolli:Vazhdojme me piken nr .3 te rendit te dites.Eshte miratimi l proces-verbalit dt 25.6.2025.

Nese jeni dakort me mua e hedhim ne votim piken nr.3 te rendit te dites.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.07. 2025

4.Pika nr ____: Leximi i vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës
25.06.2025.

5. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2025.

M.Kamolli: Vazhdojme me project-vendimin e 6%. Ky është project-vendim që ne e miratojmë çdo muaj.

Degjojme specialisten

znj.L.Mancellari:

Për muajin qershor 2025 do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike gjithsej 166 familje me fond 693604 leke.

Procedura është e njëje. E vetmja gjë që ndryshon është nr. i familjeve të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6%.

M.Kamolli: E hedhim në votim pikën nr.5 të rendit të ditës .

Ora 12:14 Vjen Znj.K.Topa

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo

6.Pika nr ____: Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec (faza1)

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me piken nr 6 te rendit te dites.Kete project-vendim na e kthehu prefektura per shkak te moskryerjes se konsultimit public dhe pasqyrimit te rekomandimeve te lena nga ministria e finances.

Znj.Karapanca:

Sic u permend edhe nga kryetarja e keshillit ky project- vendim u kthye nga prefektura per arsyet qe u permenden.Ne kryem konsultimin,kemi pasyruar edhe rekomandimet dhe tani e kemi sjelle ne keshill sebashku me tavanet buxhetore, meqense nuk kemi bere ndryshime.Gjithashtu, proçesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Znj.A.Beka:E diskutuam ne mbledhjen e komisionit .Ky eshte document qe kalon ne disa faza,por nje rekomandim ishte te rishikoheshin te gjitha fazat ne te cilen kalon PBA-ja dhe te pasqyroheshin rekomandimet.Sa jane reflektuar rekomandimet?

Znj.Karapanca:Nuk I kemi pasqyruar te gjitha rekomandimet tek PBA-ja,por vetem ato rekomandime te cilat I kemi pare te arsyeshme.

Z.A.Male;Une do te doja te rritej pesha e investimeve si dhe qe nesor do te bej nje kerkese per numrin e punonjsve qe punojne vertet ne administrate.Me rezulton qe shume punonjes nuk jane fare ,por marin rrogen.Kini fryer adminisraten dhe punonjsit kane paga te ulta si rezultat I mbingarkeses.

Nje nder rekomandimet qe ka dale nga konsultimet ka qene problem me ujin,dritat,rruget, te cilat jane edhe tani problem.Une I kam ngritur here pas here dhe asgje nuk eshte vene ne vije.

Znj.Kamolli:Ju ftoj ta hedhim ne votim piken nr.6 te rendit te dites.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 1 A. Male

Miratohet

Po JO

7.Pika nr ____: Miratimin e planit të masave për të dalë nga gjendja me probleme financiare.

M.Kamolli: Vazhdojme me piken nr 7 te rendit te dites, miratimin e planit te masave per te dale nga gjendja me probleme financiare.

Si fillim fjala per drejtoreshen znj.Irsa Karapanca.

Znj.Irsa Karapanca:

Ky Plan vjen pas Analizes vjetore te vitit 2024. Ne baze te ligjit nese perqindja ndermjet shpenzimeve te planifikuara dhe detyrimeve te prapambetura eshte nen 25 % por mbi 15% eshte ne gjendje te problemeve financiare. Duke studiuar gjendjen ne te cilen ne ndodhemi kemi menduar te kryejme disa procedura te cilat do te jene hapat e para per te dale nga kjo gjendje. Plani i masave eshte nje domosdoshmeri. Plani eshte llogaritur per 5 muajt ne vazhdim por dhe duke pare ecurine e mbledhjes se te ardhurave dhe mbledhjes se borxhit do te mundohemi qe nje pjese te tyre ta perdorim per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura.

Znj.A.Beka: Jam ne dijeni te planit .Kjo shume prej 5 miljonesh eshte planifikuar ,por nuk eshte buxhetuar.

Z.E.Shyti: Kam nje propozim drejtoreshe :Nga varrezat e fshatit Geshtenjas mblidhen rreth 18 miljone leke.A eshte e mundur qe keto leke t'i menaxhojme vete?

Ose opsioni i dyte qe bashkia te punesoje nje punonjes qe te mirmbaje varrezat dhe pjesen tjeter te lekeve ta manaxhoni ju si bashki.

Znj.I.Karapanca: Kjo mbetet per tu pare.

Znj.Kamolli: do te ishte mire hartimi i nje plani strategjik me hapa konkrete besoj.

Ka pyetje te tjera? Jo.Ne rregull ateherë ju ftoj koleg ta hedhim ne votim piken nr.7 te rendit te dites.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.01.2025

8.Pika nr ____: Për miratimin e bonusit të qerasë për znj.Mirela Basholli në Bashkinë Pogradec.

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me miratimin e bonusit te qerase per znj.Mirerla Beshello.

Znj.B.Niko:

Ka tri vjete qe zonja trajtohet me bonus qiraje.

Kryefamiljarja është person me aftësi të kufizuara dhe trajtohet me ndihmë ekonomike.

Në bazë të kushteve të vështira ekonomike ,sociale dhe jetesës, zyra e strehimit kërkon shtyrjen e afatit të subvencionimit të bonusit të qerasë edhe për 12 muaj, pasi qytetarit në fjalë akoma nuk i është gjetur një strehim përfundimtar.

Znj.Kamolli :Ju ftoj ta hedhim ne votim piken nr.8 te rendit te dites koleg.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

9.Pika nr ____: Për dhënien e ndihmës financiare për znj. Dhurata Balliu, familje që ka pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/ paisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve.

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me dhenien e ndihmes financiare per znj.Dhurata Balliu.

Fjala per drejtoreshen znj.B.Niko:Ne baze te ligjit perkates dhe duke u mbeshtetur tek verifikimet e kryera ne vendngjarje bashkia ka vendosur të akordojë ndihmën financiare për znj.Dhurata Balliu, shumë prej 1,205,374.83 (një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre) lekë, familje që ka pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve në banesë nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.

Znj.M.Kamolli:Atehere koleg ju ftoj ta hedhim ne votim piken nr .9 te rendit te dites.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

10.Pika nr : Për dhënien e ndihmës financiare z.Agron Qose, Trebinjë, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me dhenien e ndihmes financiare per z.Agron Qose per shkak te demeve te shkaktuara ne banese nga renia e zgjarrit.

Fjala per drejtoreshen znj.B.Niko:

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M Nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë kemi vendosur t’i akordojë familjes së shtetasit Agron Qose ndihmën emergjente në vlerën prej **1,871,532.25 leke**.

Znj.M.Kamolli:Atehere koleg ju ftoj ta hedhim ne votim piken nr .10 te rendit te dites.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.01. 2025

11.Pika nr : Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35,5200 ha, të ndodhura në njësinë administrative Cërravë që mund të jepen me qira.

Znj.M.Kamolli:Kjo pike kalon e konsultim public.

U votua

Pro

Kundër

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.01.2025

12.Pika nr : Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotovoltaike(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m² (treqind e trmijë e dyqind e pesëdhjete e nentëmijë) m².

Znj.M.Kamolli:Kjo pike kalon e konsultim public.

U votua

Pro

Kundër

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.01. 2025

13.Pika nr : Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-2030 të Bashkisë Pogradec.

Znj.M.Kamolli:Kjo pike kalon e konsultim public.

U votua

Pro

Kundër

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

14.Pika nr : Disa shtesa në vendimin e Këshillit Bashkiak nr 124, datë 27.11.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë”

Znj.M.Kamolli: Vazhdojme me disa shtesa në vendimin e Këshillit Bashkiak nr 124, datë 27.11.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë”.

Si fillim degjojmë drejtoreshen znj.Karafili.

Znj.Karafili: Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit propozon miratimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) vend-bregëzimeve përgjatë hapësirës ujore Fshati Lin - Bar Pelikani, që shërbejnë si stacione sezonale për hyrjen dhe daljen e turistëve/vizitorëve në mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, në Hartën e përgjithshme e cila, është pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 124, datë 27.11.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec”.

znj.S.Bozdo;Skafet ku do te pushojne?

znj.E.Karafili:Kane vendqendrimet e tyre ata.

Znj.M.Biba:Numri I shezlloneve eshte ne baze te numrit te shtreterve te hoteleve. Ne kemi gjithsej kater hotele te mbedhenj.Pse eshte mbushur plot bregu I liqenit me cadra e shezllone?

Znj.Karafili;Jane gjashte hotele te cilet kane per cdo dhome dy cifte shezllonesh.Hotelet e tjera jane me kontrata pese vjecare .Vitin qe vjen do te nxjerin aq shezllone sa u takon .

Znj.M.Kamolli;Ka pyetje ?Jo.Atehere koleg ju ftoj ta hedhim ne votim piken nr.14. te rendit te dites.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

15.Pika nr : Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.105, datë 02.12.2021 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “Harta që përcakton rrugët e qytetit , të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”, I ndryshuar.

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me project-vendimin e radhes :”Per një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.105, datë 02.12.2021 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “Harta që përcakton rrugët e qytetit , të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”, I ndryshuar.Fjala per znj.Karafili:

Znj.Karafili:Kete shtese ne vendimin nr 105,dt.02.12.2021 e kemi kerkuar per nje problem I cili na ka dale keto kohe.

Disa subjekte ne toke private ,ne ambjent te hapur po shesin rroba te perdorura ne mes te qytetit.Kjo eshte nje pamje jo e kendshme per kedo qe e has.Problemi eshte qe keto subjekte jane te paisur me nipt.

Ne kemi shtuar nje pike ne rregullore e cila I ndalon keto subjekte te ushtrojne aktivitein e tyre ne ambjent te hapur edhe pse jane te paisur me nipt.

znj.Zh.Elezi:Ne kemi shitje e produkteve buqesore ne mes te rruges dhe nuk po behet asgje.Rrezikohet jeta e qytetarve nga shitja e ketyre produkteve.

Znj.E.Karafili:Ne kishim planifikuar gritjen e tregut I cili do te na zgjidhte shume probleme,por na ka dale dicka e paplaifikuar qe lidhet me ndertimin e tregut.Ndaj duhet te mendojme si do te veprojme .Madje une nuk jam as per shitjen e fruta-perimeve ne ambjente te hapura.

Z.A.Male:Ne miratuam nje project-vendim per hapsirat publike dhe morem ne qafe gjith ato biznese.Kjo eshte e pafalshme.

Znj.E.Karafili;Asnje nga subjektet nuk ka pasur nje leje te mirfillte ,por nje leje provizore .Ne u kemi dhene leje qe te dalin me tavolina ,jo te bejne ndertime Keshtu qe gabimi ka qene I dyanshem.Une nuk jam kopetente per kete problem ,keshtu qe ju lutem te kalojme tek problemi qe po diskutonim .

Znj.M.Kamolli:Ju ftoj ta hedhim ne votim koleg kete pike.

Largohet F.Pikuli

U votua

Pro 17

Kundër

Abstenim 2 A.Male;A.Beka

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.07. 2025

16.Pika nr : Per dhenien e ndihmes financiare per z.Edmond Piperi

Znj.M.Kamolli; Vazhdojme me dhenien e ndihmes financiare per z.Edmond Piperi.
Dokumentacioni ka qene l plote,ne e kemi diskutuar edhe ne komisione.
Jemi dakort ta hedhim ne votim?Po.
Ateher e hedhim ne votim piken 16 te rendit te dites.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

17.Pika nr : “ Per miratimin e planit te arsimit parauniversitar ne Bashkine Pogradec”

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me miratimin e planit te arsimit parauniversitar ne Bashkine Pogradec.Jane ndjekur te gjitha procedurat .Kemi bere edhe konsultimin public,l cili rezultoi l suksesshem dhe me pjesmarjen e te gjitha grupeve te interest.Eshte bere nje pune shume e mire,dhe une e pergezoi grupin e punes dhe uroj qe te jete sa me l realizueshem.

Znj.A.Andoni:Kemi sjell per miratim nje plan te cilin e kemi kaluar hap pas hapi.Kemi kryer konsultimin public ,morem rekomandime nga grupet e interest dhe shpresojme te jemi te suksesshem ne realizimin e tij.

Plani që propozojmë, do të vijojë të luajë një rol të rëndësishëm për Bashkinë Pogradec, drejt rritjes së cilësisë së shërbimit të arsimit dhe konsolidimit të standardeve të tij.

Procesi i hartimit të Planit të arsimit parauniversitar në Bashkinë Pogradec (në vijim referuar si Plani) është mbështetur nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financës.

Qëllimi i këtij plani është të përmirësojë cilësinë e arsimit në Bashkinë Pogradec, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së IA, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parauniversitar. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin dhe gjetjen e zgjidhjeve efektive dhe inovative për një arsimim gjithëpërfshirës dhe të standardizuar.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Objektivat kryesore të planit përfshijnë kryesisht rikonstruksione dhe ndërtimin e një godine të re që do të shërbejë si IA me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies në çerdhe, kopshte dhe shkolla dhe më pas një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe minimizimit të braktisjes shkollore dhe orientimit të nxënësve drejt arsimit profesional.

Znj.A.Prifti :Une nuk e dija kur ishte konsultimi,por ne emer te gjithe banorve ju bej me dije se banoret dhe mesuesit nuk jane dakort qe dy shkollat tona te behen nje e Une i pergezroj rupin e punes per punen e kryer dhe nje bravo e madhe per organizimin e konsultimit .

Ka nevojë për konsultim publik kjo është.

Znj.M.Kamolli:Ne i kemi bere te gjitha lajmerimet Albana ,nuk e di pse ti nuk e ke mare vesh.

Znj.M.Shuli:

Znj.M.Biba:Une isha e pranishme ne konsultimin public qe u krye.Ishte bere nje pune shume e mire si ne hartimin e planit ashtu edhe ne organizimin e konsultimit duke qene te pranishem te gjithe grupet e interest .Une fola edhe si keshilltae ,por edhe ne emer te shkolles ku punoj.

Znj.M.Kamolli : Ju lutem ta hedhim ne votim project-vendimin e radhes.

Largohet znj.Zh.Elezi

U votua

Pro 18

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.07. 2025

18.Pika nr : Per miratimin ne parim te dhenies me qira ne favor te individve kerkues per kryerjen e operacioneve kerkues per kryerjen e operacioneve te kerkim-zbulimit hidrokarbure,gjeologjike e minerare,uji,vendosje objektesh te ndryshme ndihmse ne siperfaqe te pasurise me siperfaqe totale 40000 m2(dyzet mije)m2.

Znj.M.Kamolli:Vazhdojme me project-vendimin e radhes.Ky project-vendim u kthye nga prefektura per shkak te bazes ligjore te cilen kishim perdorur.

Nuk lejohet qe ne vendet ku ka cungishte te behen germime.

E rregulluam bazen ligjore dhe tani e sollem per miratim. Ky ishte I vetmi problem qe duhej te rregullohej.

Znj.M.Kamolli;Ju ftoj ta hedhim ne votim project –vendimin e radhes.

U votua

Pro 17

Kundër 0

Abstenim 1

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.07.2025

19.Pika nr : Per miratimin e planit te integritit per Bashkine Pogradec 2025-2028.

Znj.M.Kamolli:Kjo pike kalon e konsultim public.

U votua

Pro

Kundër

Abstenim

Miratohet

Po JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 28.01. 2025

20.Pika nr :Informacion :Barametri I barazise gjinore ,Bashkia Pogradec ,2024

Znj.M.Kamolli lexon materialin e pergatitur per barometrin gjinor,(bashkengjitur).